



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 11 prill 2025
Kodi i ZRRE: V_2696_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenin 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 16 dhe Nenit 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Dispozitat e Nenit 24 të Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Ligji Nr. 08/L-258), Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së); Dispozitat e Rregullës Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë; Metodologjinë Nr. 01/2020 për llogaritjen e çmimit referent për Energjinë e prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme, Njoftimin e ZRRE-së, për Azhurnimet vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për OST/OT, OSSH dhe FSHU, Nr. 1425/24 të datës 20.12.2024; dhe Aplikacionin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – OST/OT (KOSTT SH.A.), për azhurnimet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin 2025, të dorëzuar në ZRRE Nr. 050/25 të datës 31 janar 2025,

në seancën e mbajtur më 11 prill 2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (në tekstin e mëtejme: HLM) që do të mblidhen nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – OST/OT (KOSTT SH.A.), për vitin relevant tarifar 2025.**
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mblidhen nga OST/OT për vitin relevant tarifar 2025 duke përfshirë Fondin për Burimet e Ripërtërishme janë gjithsejtë në shumën e 88,198,071 €.**
- III. Fondi i Burimeve të Ripërtërishme bazuar në prodhimin e planifikuar të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë për vitin relevant tarifar 2025 është në shumën e 17,343,528 €.**
- IV. Çmimi referent i Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, i cili do të aplikohet për vitin tarifar 2025 është 65.12 €/MWh.**
- V. OBLIGOHET - Operatorit të Sistemit, Transmisionit, Operatori i Tregut (OST/OT) në përputhje me Metodologjinë e Përcaktimit Tarifave dhe Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, që të përgatisë dhe dorëzojë për aprovim në ZRRE tarifat e transmetimit, operimin e sistemit dhe operimin e tregut bazuar në HLM e OST/OT-së, si dhe tarifat për Fondin e Burimeve të Ripërtërishme për Energji (BRE), sipas këtij Vendimi.**
- VI. Ky vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Tregut (OST/OT-KOSTT) duke filluar nga data 1 maj 2025.**



- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 20 dhjetor 2025 ka iniciuar procesin: Azhurnimet Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit, të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (OST/OT).
- ZRRE sipas njoftimit të saj ka vlerësuar se ky proces i Azhurnimeve vjetore të të hyrave dhe tarifave për vitin relevant tarifar 2025, ka për qëllim që të siguroj që të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për të licencuarit e rregulluar të jenë në përputhje dhe në pajtueshmëri me kostot reale dhe parashikimet për periudhën tarifore.
- ZRRE ka njoftuar se në pajtim me Rregullat e të Hyrave për të Licencuarit, parashikimet duhet azhurnuar për të marr parasysh dallimet nëpërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Pra, përshtatjet barten në vitin vijues, apo dallimet e vitit t-1 barten në vitin "t" në kuadër të procesit relevant tarifar. Po ashtu ka theksuar se pas mbledhjes së të dhënave relevante nga të licencuarit, do të analizoj dhe vlerësoj aplikacionet e të licencuarve për të përcaktuar kostot reale që reflektohen në tarifat përkatëse.
- ZRRE përmes njoftimit ka theksuar se do të bëjë publike aplikacionet për aq sa lejon legjislacioni përkatës, në momentin që vlerësohen se janë kompletuar dhe do të siguroj të gjitha palët e interesit që analizat e ZRE-së, bërë këtyre të dhënave dhe propozimet e saja do të bëhen publike dhe do të vendosen në konsultim publik, ashtu që vendimet përfundimtare marrin parasysh të dhënat relevante dhe komentet nga palët e interesit.
- Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit për të hyrat e lejuara maksimale, në kuadër të procesit të shqyrtimit të aplikimit dhe sqarimeve të mëtejshme, ZRRE nëpërmjet korrespondencave të vazhdueshme, ka kërkuar nga OST/OT SH.A. dhënien e informacionit, përditësimin e të dhënave, argumenteve dhe dokumentacionit justifikues lidhur me të gjitha çështjet e evidentuara në mënyrë që të kemi transparencë për marrjen e një vendimi të drejtë e kosto reflektues të tarifave.
- ZRRE më datë 31 janar 2025 nga Operatori Sistemit të Transmetimit dhe Tregut – KOSTT SH.A ka pranuar aplikacionin për Hyrat e Lejuara Maksimal për vitin 2025.
- ZRRE pas vlerësimit fillestar të Aplikacioneve me të dhënat e realizuara dhe parashikuara me treguesit teknik, ekonomik dhe financiar lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për të licencuarin Operatorin e Sistemit, të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.
- ZRRE më datë 14 mars 2025 ka publikuar Raportin Konsultativ Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT, viti relevant tarifar 2025.
- Raporti konsultativ ka paraqitur propozimet e ZRRE-së, për HLM që do të mbulohen nga OST/OT gjatë vitit relevant tarifar 2025. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të miratuara do të përcaktojnë tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operimin e sistemit dhe operimin e tregut, tarifat për fondin e BRE-ve të cilat do të ju ngarkohen shfrytëzuesve të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Tregut. Raporti konsultativ për OST/OT ka trajtuar Shpenzimet e Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, kostoja e zhvlerësimit dhe kthimi i lejuar, që do të përcaktohen nga ZRRE gjatë shqyrtimeve periodike në bazë reale (pa përfshirë inflacionin). Rrjedhimisht këto kosto duhet të indeksohen me normën e inflacionit gjatë çdo përshtatje të rregullt vjetore. Rregulla për të Hyrat e Lejuara të OST-së përcakton që kostot duhet të indeksohen me normën e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, të publikuar nga Eurostat për 20 vendet e Eurozonës, e cila për vitin 2024 ishte 2.36%.



- Raporti konsultativ gjithashtu ka trajtuar edhe kostot e shërbimeve ndihmëse për vitin 2025, duke i vlerësuar edhe kostot e shërbimeve ndihmëse të realizuara gjatë vitit 2024. Përmes raportit ka trajtuar edhe azhurnimet e parashikimit të humbjeve të lejuara të OST, duke marr parasysh edhe Bilancin e Energjisë për vitin 2025, ka trajtuar edhe parashikimin e kostove të blerjes së energjisë për import në vitin 2025, parashikimin e kostove për humbjet e OST në vitin 2025, çmimin referent për vitin 2025, bazuar në Metodologjinë Nr. 01/2020 për llogaritjen e çmimit referent për Energjinë e prodhuar nga BRE, përshtatjet për faktorin korrigjues të të hyrave për vitin e realizuar 2024, përshtatjet e kostove të humbjeve për vitin 2024, shërbimeve ndihmëse, fondin për BRE 2024, korrigjimet për të hyrat jo tarifore 2024 dhe ka paraqitur propozimin fillestar për të Hyrat e Lejuara maksimale për OST/OT, për vitin 2025.
- Raporti është vënë në diskutim publik me synimin që të marrë komentet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së.
- ZRRE gjatë konsultimit publik ka pranuar komente nga qytetarët dhe palë të ndryshme të interesit, përshtirë: INDEP, organizatat e shoqërisë civile, Green Energy Kosova, Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe ndërmarrjet energjetike.
- Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut ka dorëzuar komentet me datë 28 mars 2025, ndaj Raportit Konsultativ për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT.
- ZRRE i ka analizuar në detaje të gjitha komentet e paraqitura dhe i vlerëson ato si pjesë e rëndësishme e procesit të konsultimit publik. ZRRE ka pranuar disa komente të ngjashme apo të njëjta nga qytetarë të ndryshëm, ndërsa në Raportin Përfundimtar (Përgjigjet ndaj komenteve) janë paraqitur komentet dhe përgjigjet për secilën nga çështjet e ngritura nga qytetarët dhe palët e interesit, dhe pas analizimit dhe vlerësimit profesional ka paraqitur përgjigjet me shkrim të cilat i ka përfshirë në Raportin Përfundimtar.
- Raporti Përfundimtar i Shqyrtimit të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT, përfshinë edhe të dhënat e përditësuara nga OST/OT ku pas analizimit nga ZRRE janë marrë në konsideratë në vlerësimet përfundimtare.
- ZRRE në Raportin përfundimtar ka trajtuar edhe revidimet në kostot e parashikuara të shërbimeve ndihmëse, ku nga KOSTT ka kërkuar të dhëna shtesë gjatë procesit të konsultimit publik në lidhje me të kostot e parashikuara për shërbimet ndihmëse. Vlen të theksohet se ZRRE ka bërë revidimin e çmimeve për shërbimet ndihmëse aFRR në bazë të çmimeve të kaluara të kontraktuara për vitin 2024, ku nga çmimet e marra për aFRR që ishin 48.8 €/MW për ngritje dhe 45.8 €/MW për zbritje i ka reviduar këto çmime duke marrë parasysh edhe çmimet për shërbime ndihmëse të vitit 2023. Çmimet e reviduara mesatare për shërbime ndihmëse aFRR janë parashikuar të jenë 41.3 €/MW për ngritje dhe 35.4 €/MW për zbritje. Prandaj, në total kosto e shërbimeve ndihmëse të parashikuara për 2025 është reviduar nga €43.12 milionë në €37.72 milionë.
- Kostot e shërbimeve ndihmëse janë detyrime që burojnë nga Kodi i Rrjetit (Kodi i Balancimit) ndërsa çmimet e rezervave i nënshtrohen kushteve të tregut mbi të cilat ZRRE nuk ka kontroll në pajtim me Nenin 13.2 i Rregullave të Tregut. Arsyeja kryesore e rritjes së kostos së shërbimeve ndihmëse vjen nga rritja e kontraktimit të kapaciteteve aFRR dhe mFRR si pasojë e kërkesave të ENTSO-E për përmirësim të balancimit të sistemit. Rezerva automatike aFRR është rritur nga +/- 25 MWnë +/- 40 MW. OST/OT siguron këtë rezervë përmes ankandëve javore nga OST e Shqipërisë. Çmimet për këto shërbime janë të ndryshme për çdo muaj dhe ndryshojnë në varësi të llojit të kapacitetit të ofruar dhe kohëzgjatjes.



- Me Vendimin Nr. 08/236 të datës 11.12.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – OST/OT (KOSTT SH.A.), në kuadër të funksionit të Operatorit të Tregut, është caktuar si subjekt për ushtrimin e kompetencave të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme, i cili është i obliguar të përmbush të gjitha detyrimet që ndërlidhen me mbështetjen e projekteve të Energjisë nga BRE, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-258 dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Kostot e Skemës Mbështetëse dhe të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme mbulohen nëpërmjet Fondit Mbështetës për Energjinë nga Burimet e Ripërtërishme që përbëhet nga fondet e arkëtuara në kuadër të Obligimeve të Energjisë të Ripërtërishme. Fondet nga Obligimi për Energji nga Burimet e Ripërtërishme arkëtohen nga të gjithë furnizuesit që furnizojnë konsumatorët fundorë në baza mujore dhe llogariten për kWh të konsumuar.
- Tarifa e Fondit për Energjinë e Ripërtërishme llogaritet në përputhje me Rregullat e Skemës Mbështetëse, si pjesë e rregullave të përcaktuara për funksionimin e Fondit BRE. Ajo është një tarifë e veçantë në nivelin e transmetimit, e cila mbulon kostot e operimit të Fondit për Energjinë e Ripërtërishme.
- Fondi i Burimeve të Ripërtërishme përdoret për të paguar diferencën në mes të tarifave sipas skemës mbështetëse dhe çmimit referent dhe prodhuesve të energjisë në kuadër të tarifave sipas skemës mbështetëse. OST në vazhdimësi publikon raporte mbi performancën dhe prodhimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë brenda fondit të BRE. Si rezultat i monitorimit të vazhdueshëm aplikohet një korrigjim për kostot e fondit të BRE për vitin 2024 në vlerë prej - 4,114,244 €, €/MWh, e cila përfshin diferencën mes të hyrave dhe shpenzimeve të Fondit të BRE për vitin 2024. Ky korrigjim është ndaras nga kostoja e fondit të BRE-ve, për vitin 2025.
- Prandaj pas analizimit dhe vlerësimit është konstatuar se vlera e kostove të Fondit të BRE-ve, për vitin 2025 do të jetë prej 17,343,528 € e cila është rezultat i prodhimit të planifikuar të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe përlllogaritjes së çmimeve (Vlera Kostove të Fondit = (Feed-in Tarifa – Çmimi Referent) × Prodhimi i energjisë nga secila njësi gjeneruese, pastaj i shtohet kostoja e menaxhimit të fondit dhe kostoja e imbalancave. Ngjashëm në vitet në vijim të periudhës rregullative kostot e fondit të BRE-ve do të përshtaten për të marrë parasysh dallimet ndërmjet parashikimit dhe realizimit.
- Për sa i përket çmimit referent për energjinë e prodhuar nga Burimet Ripërtërishme të Energjisë (BRE) kalkulohet duke përdorur një metodologji të caktuar që është e përcaktuar për të siguruar një proces të drejtë dhe transparent në përcaktimin e këtij çmimi. Ky çmim është i lidhur drejtpërdrejt me çmimin që Operatori i Tregut të Energjisë e aplikon për energjinë që shitet nga prodhuesit e energjisë nga BRE tek furnizuesit. Metodologjia e përdorur për llogaritjen e çmimit referent për energjinë e prodhuar nga BRE është e përcaktuar në Nenin 5 të Metodologjisë Nr. 01/2020. Parimet bazat për përcaktimin e çmimit referent janë si vijon: Sasia e kërkesës së zhvendosur bazohet në renditjen meritore të kërkesës, ku burimi më i shtrenjtë gjenerues zëvendësohet i pari dhe burimi më i lirë zëvendësohet i fundit; Çmimi referent për orë bazohet në vëllimin e gjenerimit nga BRE-të dhe kostot e alternativave të zhvendosura në atë kohë për atë vëllim; dhe Llogaritja e çmimit vjetor referent bazohet në vlerat aktuale të burimeve të zhvendosura të energjisë elektrike për orë, për të gjithë vitin, dhe pjesëtimi me vëllimin e pritur të gjenerimit nga BRE-të për orë, për të gjithë vitin. Prandaj bazuar në këto parime ligjore çmimi referent i Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, është përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi.
- Andaj, të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mblidhen nga OST/OT duke përfshirë Fondin për Burimet e Ripërtërishme për vitin relevant tarifar 2025 janë gjithsejtë në shumë e 88,198,071 €, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij Vendimi.



- Vlen të theksohet që të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT-në do t'i nënshtrohen procesit të Përshtatjeve të Rregullta Vjetore, sipas Rregullës Nr. 03/2017 për Të Hyrat e OST/OT-së, të nxjerr nga ZRRE.
- Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Lutfije Gashi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KOSTT,
- KEDS, dhe KESCO.
- Arkivit të ZRRE-së.